

### **Aneks 3: RAPORT I KONSULTIMIT PUBLIK**

Draft Akti/Dokumenti i Politikës:

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave synon miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020 – 2022. PKIE 2020 – 2022 do të shërbejë si instrument i planifikimit dhe monitorimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe i procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. PKIE 2020 – 2022 synon prioritizimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e përafrit të plotë të legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit Evropian si një nga kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Kohëzgjatja e Konsultimit:

Konsultimi publik I Vendimit të Këshillit të ministrave për miratimin e planit kombëtar për Integrimin Evropian ka patur një kohëzgjatje 20 ditore nga momenti i shpalljes në faqen zyrtë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Nuk ka patur konsultime gjatë fazës së hartimit të këtij dokumenti.

Aktivitetet e Konsultimit:

Aktiviteti I konsultimit startoi me publikimin online në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të njoftimit për konsultimin e projektvendimit mbi miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022(PKIE 2020-2022) në datë 31.12.2019 <https://punetejashtme.gov.al/sherbime-dhe-mundesi-njoftime/> . Nëpërmjet këtij njoftimi, njoftoheshin të gjithë personat e interesuar të merrnin pjesë në takimin që do të mbahesh më datë 20.01.2020 për konsultimin publik të PKIE 2020-2022.

Gjithashtu MEPJ njoftojë me postë elektronike të gjitha kontaktet e shoqërisë civile që dispononte për datën e konsultimit publik dhe në këtë komunikim përcolli për dijeni dhe projektvendimin që do konsultohesh.

Aktorët e përfshirë:

Në takimin e datës 20 janar 2020 morën pjesë përfaqësues nga pushteti lokal dhe 1 përfaqësues nga shoqëria civile.

Komentet dhe Propozimet e marra:

*Organizo komentet dhe propozimet e marra sipas çështjeve më të cilën lidhen. Mblidh komentet e përbashkëta dhe listo aktorët që i ngrenë ato. Shpjego nëse janë pranuar apo jo, dhe jep shkurtimisht arsyen.*

Çështjet e konsultuara	Komentet e grumbulluara	Aktorët	Vendimi mbi komentet (pranuar/pranuar pjesërisht/refuzuar)	Justifikimi
Përfaqësuesit e pushtetit lokal mbështetën përfrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin Evropian dhe në tërësi procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.	Gjithashtu u shkëmbyen mendime mbi forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si koordinatore e procesit të anëtarësimit dhe pushtetit lokal	Përfaqësues të pushtetit lokal	Pranuar	Me miratimin e vendimi të Këshillit të ministrave nr.450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendor”, dhe krijimin e strukturave të integrimit Evropian pranë pushtetit lokal, kontributi i këtyre strukturave në proceset e integrimit Evropian dhe PKIE, është një kontribut i nevojshëm për procesin e anëtarësimit në BE.